

PROCESVERBAL
nga seanca e 21-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 10.05.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, mr. Magdalena Dovleva Davidovska, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Dragana Veljanovska nga misioni vëzhgues i Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut OSBE (ODIHR).

Z. Petrushevski hapi seancën e 21-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancën së 18-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.05.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.05.2024.
3. Raport për reklamimin e paguar politik të transmetuesve për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale 2024.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 nga LSHMAAV.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: pijeve.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim : Riçertifikimi i standardit ISO 9001:2015 sistem për menaxhim të cilësisë.
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 18-të të Këshilli të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.05.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 02.05.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin për reklamimin e paguar politik të transmetuesve për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale 2024. Ai shpjegoi se në bazë të Kodit Zgjedhor, ASHMA duhet të dorëzojë Raport në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve për reklamat politike me pagesë (RPP), tani për rrethin e parë dhe më pas plotësuese dhe për rrethin e dytë. Ky dokument përfshin kohën e shfrytëzuar nga shtatë kandidatët për RPP, që së bashku patën mundësinë të shfrytëzojnë 9 minuta e 30 sekonda në pajtim me Udhëzimin që përgati Agjencia. Ai theksoi se duhet pasur parasysh se te disa transmetues ka pasur tejkallim të kohës së RPP në krahasim me media planet të dakorduara me partitë politike, por Agjencia këto tejkallime nuk i ka përfshirë në këtë Raport sepse nuk ka qenë kërkesë e partive politike, por televizionet për arsye teknike kanë transmetuar më shumë reklama. RPP paguhet nga buxheti i shtetit dhe për të mos ardhur deri tek dëmtimi i buxhetit, ato reklama që janë të tepërta dhe nuk përputhen me media planet janë mënjanuar nga Raporti. Gjithashtu, nga Raporti janë mënjanuar dhe ato RPP për të cilat Agjencia ka ofruar kallëzim penal, gjegjësisht ato sekonda që ishin jashtë kufijve të RPP nuk janë përfshirë në Raport. Më 2 maj, Agjencia ka dhënë Çertifikata veçmas për të gjithë transmetuesit për secilin kandidat që ka shfrytëzuar kohën për RPP, dhe Raporti i sotëm në fakt paraqet një sublimim, pra përmbledhje të të gjitha atyre Çertifikatave që u janë dhënë transmetuesve. Gjatë kohës së rrethit të parë të Zgjedhjeve presidenciale në 37-të televizione janë transmetuar gjithsej 436 orë 44 minuta e 30 sekonda, ndërsa në 27-të radio 130 orë 37 minuta dhe 9 sekonda, pra gjithsej nga të gjitha televizionet dhe radiot 567 orë 21 minuta dhe 39 sekonda. Nga 9 televizionet kombëtare volum më të madh kohë reklamimi kishte TV Alsat-M, TV Kanal 5 dhe TV Kompani 21 -M, ndërsa nga radiot kombëtare kohë reklamimi më shumë shitën RA Antena 5 dhe RA Jon. Ai ka shpjeguar se në Raportin e dorëzuar janë elaboruar në detaje të gjitha elementet e RPP-së dhe nëse ka pyetje përgjigje do të japë udhëheqësja mr. Emilija Janevska.

Z. Petrushevski tha se është e qartë se Raporti është përgatitur në detaje, se është investuar një punë e madhe dhe e përgëzoi Shërbimin për saktësinë e tij. Nga pikëpamja politike nuk është aq e rëndësishme, por nga aspekti financiar është shumë i rëndësishm për transmetuesit. Shpreson që mendimi i Agjencisë dhe i shumë të tjerëve se duhet të hiqet reklamimi i paguar politik me mjetet nga buxheti dhe në të ardhmen të pranohet dhe deklaroi se do të mbështesë Raportin.

Z. Fidanoski tha se edhe ai është një nga ata që konsideron se nuk është i nevojshëm ky lloj financimi i RPP, por përderisa është përcaktuar ligjërisht si obligim, Ligji duhet të zbatohet. Ky Raport sipas tij është pjesë thelbësore e zinxhirit në procesin e pagesës së mjeteve të marra nga transmetuesit për transmetimin RPP. Është në pajtim se bëhet fjalë për një Raport të detajuar dhe gjithëpërfshirës. Drejtori Trajçevski i paraqiti të dhënat, tha se janë disa qindra Çertifikata të dhëna veç e veç që në këtë Raport janë paraqitur të përmbledhura

(si sublimim). Përshtypja e tij nga Raporti është se tek televizionet kushtimisht thënë ka dominim në RPP të kandidatit për president Stevo Pendarovski, ndërsa në radio një dominim i tillë shkon në llogari të presidentes tashmë të zgjedhur Gordana Siljanovska Davkova. Ajo që ai vuri re gjithashtu është se ka një disbalancë në RPP në një televizion kombëtar, por kjo mund të jetë zgjedhja e kandidatëve të tjerë që kanë vendosur të mos reklamohen në atë medium, siç disa nga kandidatët abstenuan nga RPP dhe në televizionet e tjera kombëtare. Një trend i tillë mund të thuhet se ka pasur edhe në disa radio stacione, disa prej kandidatëve kushtimisht thënë kanë munguar në transmetim, që ndoshta ka qenë zgjedhja e tyre. Ai deklaroi se do të mbështesë Raportin.

Z. Ajdini tha se nga Raporti shihet puna voluminoze e Agjencisë e paraqitur në shifra, nga ku shihet se kandidatët gjerësisht janë reklamuar. Sipas tij, ky dokument përmban të gjitha të dhënat dhe tha se do të mbështesë Raportin.

Z. Trajçev tha se bëhet fjalë për një Raport voluminoz në të cilin është investuar shumë mund (punë) nga Agjencia. Ai beson se është punuar me saktësi dhe se ky Raport paraqet tablonë e gjendjes reale dhe faktike të periudhës dhe kohës, ku për secilin transmetues në veçanti ka të ndarë RPP për secilin kandidat. Ai deklaroi se do ta mbështesë Raportin sepse beson se në mënyrë të saktë dhe objektive është paraqitur tabloja e rrethit të parë të Zgjedhjeve presidenciale. Në pjesën e analizës së numrave nuk do të hyjë për arsye se ASHMA-ja më tej nuk është kompetente për financat dhe pagesat, kompetenc e Agjencisë është vetëm të vlerësojë nëse është respektuar Ligji dhe Udhëzimi që është miratuar për pjesën e kufirit të lejuar për RPP. Sipas tij, kjo është një bazë reale, e saktë që institucionet e tjera të mund të bëjnë analizat e tyre në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimit të tyre. Ai deklaroi se si Raport përfundimtar për rrethin e parë të Zgjedhjeve presidenciale do të japë mbështetje dhe është i bindur se shifrat e dhëna në të janë të sakta, të qarta dhe të matura saktësisht nga shërbimet e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Raportin për reklamat politike me pagesë të transmetuesve për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Presidenciale 2024, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur, ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Spektori për çështje programore, Raportin e lartpërmendur, ta dorëzojë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pika 4

Z. Trajçevski e shpjegoi propozimin për shqiptim e masës paralajmërim publik të operatorit TOTAL TV nga Shkupi për shkelje të nenit 143 nga LSHMAAV. Ai shpjegoi se tek ky operator i rrjetit publik të komunikimit është konstatuar se nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore të "TVM 2", "TVM 4" dhe "TVM 5", gjë që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të LSHMAAV. Sepse në këtë vit kalendarik për herë të parë është konstatuar shkelje, dhe propozohet që t'i shqiptohet masë paralajmërim publik, më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të parë nëse ka vepruar sipas masës së shqiptuar dhe urdhërohet që menjëherë të fillojë ritransmetimin e këtyre shërbimeve programore.

Z. Petrushevski tha se Këshilli disi është mësuar me këtë shkelje të operatorit, e cila zakonisht përfundon me inicimin e procedurës për kundërvajtje të cilën TOTAL TV rregullisht e paguan.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-2018/1 të datës 23.04.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për Tregti dhe Shërbime t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 143 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 e urdhëroi që menjëherë pas marrjes së Aktvendimit për paralajmërim publik të harmonizon punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatuar se Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, që sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikim Elektronike mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pakon e tij programore nuk ka ofruar shërbimet programore të shërbimi publik transmetues, gjegjësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore "TVM 2", "TVM 4" dhe "TVM 5", gjë që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Spektori për Çështje Juridike duhet të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik operatorit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, e shpjegoi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: pije. Ajo ka shpjeguar se për realizimin e këtij furnizimi janë përmbushur obligimet ligjore, është e paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 dhe mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024 dhe do të parashikohen në pajtim me Planin financiar për vitin 2025, sepse marrëveshja që do të rezultojë nga zbatimi i këtij furnizimi do të lidhet për një periudhë dyvjeçare. Sipas shumës së parashikuar të mjeteve, ky furnizim do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët në pajtim me të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure, që do të thotë se do të publikohet edhe në sistemin elektronik të furnizimit publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: pije për nevojat e Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - mallra: pije për nevojat e Agjencisë, është paraparë dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 të datës 22.12. 2023, dhe mjetet janë siguruar nga Planin Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, përkatësisht të njëjtit do të parashikohen më tej në Planin Financiar për vitin 2025.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim : Riçertifikimi i standardit ISO 9001:2015 sistem për menaxhim të cilësisë. Ajo shpjegoi se ky furnizim është paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 dhe mjetet janë të siguruara nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024, gjegjësisht meqënëse marrëveshja që do të dalë do të lidhet për periudhë prej tre vjetësh, përkatësisht do të sigurohen dhe me Planin financiar për vitin 2025 dhe 2026. Do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët, duke respektuar të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure, që do të thotë se do të publikohet edhe në sistemin elektronik të furnizimit publik.

Z. Petrushevski tha se e përkrah këtë furnizim, tregon për cilësinë e punës së Agjencisë dhe kështu duhet që ky institucion edhe në të ardhmen të vazhdojë, me përsosjen e vazhdueshëm të sistemit dhe procedurave me të cilat punon. Dëshmitarë janë vetë se kjo është vërtet në nivel të lartë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: riçertifikimi i standardit ISO 9001:2015 sistem për menaxhim të cilësisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: riçertifikimi i standardit ISO 9001:2015 sistem për menaxhim të cilësisë, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024, përkatësisht të njëjtit do të sigurohen në Planin Financiar për vitet 2025 dhe 2026.

Pika 7

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**